

UDHËZIM
Nr. 199, datë 12.4.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË
BRENDSHËM DHE TË MINISTRIT PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NR.
64, DATË 4.2.2021, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM, FORMËN DHE MËNYRËN E
PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E
SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR PERSONAT QË BANOJNË JASHTË TERRITORIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, nr. 64, datë 4.2.2021, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, për personat që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 2, të kreut V, “Rregulla dhe procedura të përgjithshme”, fjalia e parë ndryshon si vijon:

“Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar duhet të mos kapërcejnë tre muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre.”.

2. Ngarkohen strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka